

HAPAT QË DUHEN NDJEKUR NËSE DHUNOHESH:

- **TELEFONO: 129 OSE 116117**
- **DREJTOJU: KOMISARIATIT MË TË AFËRT TË POLICISË (TË ZONËS KU BANONI OSE NDODHENI)**
- **DREJTOJU: NJËSIVE PËRKATËSE ADMINISTRATIVE DHE BASHKISË**
- **DREJTOJU: QENDRËS SHËNDETËSORE TË ZONËS KU BANONI APO NDODHENI**

Këto institucione kanë detyrim ligjor të marrin masa të menjëhershme për mbrojtjen tuaj, duke përfshirë URDHRIN PARAPRAK TË MBROJTJES SË MENJËHERSHME (UPMM).

Autoritet e mësipërme kanë gjithashtu detyrimin t'ju informojnë dhe ofrojnë shërbime të tjera, si ndihmë mjekësore, këshillim psikosocial, ndihmë ligjore, strehim në strehëzat e emergjencës gjatë kohës së rrezikut, etj.

Kundër dhunës në familje është ngritur "Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje" (MKR), i cili përbëhet nga institucionet përgjegjëse në nivel vendor dhe kanë detyrimin ligjor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje.

Policia e shtetit: Ka detyrimin ligjor të marrë masa të menjëhershme mbrojtëse për viktimën, asiston në plotësimin e Kërkesë-Padisë për Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes drejtuar Gjykatës. Policia koordinon veprimet me Strehëzat apo Shërbimin Social për strehimin e menjëhershëm të viktimës së dhunës në familje dhe fëmijëve të saj, në rastet kur u kërcënohet jeta dhe shëndeti. Merr masa dhe vë para përgjegjësisë ligjore autorin/en e dhunës.

Bashkia: Ka detyrimin ligjor të udhëzojë gruan ose vajzën që ndihet e dhunuar. Çdo bashki ka një koordinator vendor kundër dhunës në familjes, i cili sipas rastit që i paraqitet bën referimin dhe i jep zgjidhjen e duhur rastit të dhunës në familje.

Qendrat Shëndetësore pranë njësive të qeverisjes vendore: Kanë detyrimin ligjor të ofrojnë në çdo kohë ndihmë mjekësore për viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu këto qendra kanë detyrimin t'ju pajisin me një raport për dëmtimet që ju janë shkaktuar, të cilin mund ta përdorni si provë në Polici ose Gjykatë.

*Kjo fletëpalosje është hartuar nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" (GADC) në kuadrin e projektit "Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit". Projekti zbatohet në kuadër të programit "**Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë**" - kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UN Women. Përmbajtja e fletëpalosjes është përgjegjësi vetëm e Qendrës "Aleanca Gjinore për Zhvillim" dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo UN Women.*

**Nëse dhunoheni apo diskriminoheni në vendin e punës
TELEFONO PA PAGESË në numrin jeshil 0800 1818**

Adresa:

Rr. "Abdyl Frashëri" P. 10/1, Ap 3 P.O.Box. 2418, Tiranë

Web: www.gadc.org.al

Tel: 00355 422 555 14; 00355 422 555 15

Email: gadc@gadc.org.al



ZBATOJMË INORMAT,
NDRYSHOJMË MENDËSITË!

BASHKOHUNI ME NE PËR TI THËNË STOP DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE!

Kjo fletëpalosje përmban informacion për gra e vajza që përjetojnë dhunë të çfarëdo forme, përfshirë seksuale apo dhunë në familje.

BESO!

DËGJO!

MBËSHTET!

**THYEF
HESHTJEN**



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim





Fizike

Psikologjike

Seksuale

Dhuna në familje shfaqet në disa forma:

DHUNA PSIKOLOGJIKE (e cila konsiston në bëritje, fyerje, frikësim, kërcënime) që është forma më e shpeshtë e shfaqur;

DHUNA FIZIKE (e cila shfaqet në formën e rrahjes, goditjes, pickimit, kafshimit, shtyrjes, mbytjes, djegies, shkelmimeve etj);

DHUNA SEKSUALE (e cila ka të bëjë me detyrimin për të kryer marrëdhënie seksuale të padëshiruara nga ana e partnerit);

Ligji shqiptar ju mbron nga këto forma dhune:

- Dhunë të ushtruar në marrëdhëniet familjare (dhuna fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike);
- Ngacmimi seksual;
- Dhunën seksuale, përfshirë përdhunimin;
- Martesat e detyruara, sidomos martesat e vajzave nën moshën 18 vjeç;
- Përndjekjen;
- Abortin e detyruar.

Me ndryshimet e reja në ligjin "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", në fuqi që nga data 18 Nëntor 2020, çdo dhunues do të dëbohet menjëherë nga shtëpia në rast dhune!

POLICIA ËSHTË INSTITUCIONI I CILI DO TË VIJË NË NDIHMË.

Që nga data 18 nëntor 2020 ndër të tjera ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare vijon si më poshtë:

- **GARANTIMIN** e mbrojtjes me masa ligjore dhe masa të tjera të nevojshme të anëtarëve të familjes që janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji.
- Gjykata, si masë mbrojtëse e dhunës në familje, **URDHËRON** menjëherë abuzuesin të largohet nga banesa për një periudhë të caktuar kohe, kur viktimë dhe autori i krimin banojnë në të njëjtën shtëpi. (Largimi i abuzuesit nga banesa bëhet nga policia, derisa gjykata të lëshojë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes në Urdhrin Paraprak të Mbrojtjes së Shpejtë.)
- Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar nga një vendim gjykate, dhunuesi udhëzohet të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosocial dhe / ose programe trajnimi për prindërim, të organizuara nga ente publike ose private.
- Në çdo rast, oficeri i policisë, ku viktimë paraqitet për mbrojtje, i **RAPORTON** çështjen organit të ndjekjes penale për ndjekjen penale të autorit sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

DUHET TË DINI SE!

Ndalohet zgjidhja e rasteve të dhunës në familje me pajtim ose ndërmjetësim.

NËSE NDIHESH E KËRCËNUAR/ E PËRNDJEKUR MOS HEZITO! TELEFONO NË NUMRAT E MËPOSHTËM TË CILËT JU PËRGJIGJEN NË ÇDO ORË TË DITËS DHE NATËS DHE JANË PA PAGESË!

- **POLICIA E SHTETIT QARKU TIRANË: 112**
- **POLICIA E SHTETIT QARQET E TJERA: 129**
- **URGJENCA MJEKËSORE: 127**
- **LINJA KOMBËTARE E KËSHILLIMIT: 116117**

Ju mund të telefononi në numrat:

- **Vlorë:** Klinika Ligjore: Cel: 0699333523 (24 orë)
Tel. 033224078; 033228048
- **Durrës:** Numër pa pagesë: 08009888,
TEL: 052 234 600
- **Shkodër:** Tel: 0035522241154,
Cel: 00355693310172
(8.00-16.00, nga e hëna në të premte)
- **Elbasan:** Cel: 0355696511674, 00355682218459;
Tel: 0035554254516
(8.00-16.00, nga e hëna në të premte)
- **Korçë:** Numri pa pagesë: 08003434
(8.00-16.00, nga e hëna në të premte)
- **Tiranë:** Emergjencia: 0800 0888
- **Berat:** Shërbimi Social:
Tel: +355684863475 / +355684863474

BOTAPORTOKALLI ORANGETHEWORLD

